



Politika për aktivitete bahkëkurrikulare dhe jashtëkurrikulare në Kolegjin BIZNESI është hartuar në mbështetje të Vendim të Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor, bazuar në Ligjin nr. 04/L-037 "Për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës", në Statutin e Kolegjit neni 81; në Rregullore e brendshme e Kolegjit BIZNESI, kreu 6 dhe neni 79, 80 dhe 81; si dhe në gjithë legjislacionin tjetër në fuqi dhe që është miratuar me Vendim të Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor datë 27.09.2024, të Kolegjit BIZNESI.

POLITIKA PËR AKTIVITETE BASHKËKURRIKULARE DHE JASHTËKURRIKULARE NË KOLEGJIN BIZNESI

Qëllimi i Politikës për aktivitete bahkëkurrikulare dhe jashtëkurrikulare në Kolegjin BIZNESI është të përkufizoj dhe shpjegojë pritshmëritë e Kolegjit Biznesi nga realizimi i aktiviteteve bashkëkurrikulare dhe jashtëkurrikulare, me qëllim që studentëve tu ofrohet përvojë arsimore dhe edukative gjithëpërfshirëse. Politika është dokument publik dhe i publikuar në ueb faqen e institucionit:

Bazuar në Vizionin, Misionin dhe Vlerat e përcaktuara Kolegji Biznesi gjatë realizimit të procesit edukativ dhe arsimor duke pasur qasjen "studenti në qendër" është i përkushtuar që të zhvillojë studentët përmes aktiviteteve kurrikulare, bashkëkurrikulare dhe ekstrakurrikulare.

- **Aktivitetet kurrikulare** të cilat janë drejtpërdrejt të bazuara në syllabuset e lëndëve.
- **Aktivitetet bashkëkurrikulare** janë aktivitete të sponsorisuar nga institucioni që pasurojnë dhe mbështesin aktivitetet kurrikulare. Boshllëqet që lënë aktivitetet kurrikulare, synohet të mbulohen dhe plotësohen nga aktivitete bashkëkurrikulare. Me ndihmën e këtyre aktiviteteve mundësohet zgjerimi i aktiviteteve kurrikulare. Studentët për ngarkesën e tyre në aktivitetet bashkëkurrikulare të realizuara nuk fitojnë ECTS kredi.
- **Aktivitetet Ekstrakurrikulare** nuk janë të përfshira në syllabuse, por, janë ato aktivitete që realizohen jashtë syllabusit, por, janë nën mbikëqyrjen e institucionit. Këto aktivitete janë shumë të rëndësishme për të gjitha fushat e zhvillimit të studentëve. Studentët për ngarkesën e tyre në aktivitetet jashtëkurrikulare të realizuara nuk fitojnë ECTS kredi dhe këto aktivitete nuk janë pjesë e vlerësimit përfundimtar të studentit.



Formulimi i Politikës

Brenda qasjes gjithëpërfshirëse ndaj arsimit dhe edukimit, Kolegji Biznesi e sheh ofrimin e një game të gjerë të Aktiviteteve Bashkëkurrikulare dhe Jashtëkurrikulare si jetike për t'u mundësuar studentëve të Kolegjit akses në një gamë sa më të gjerë përvojash. Këto aktivitete përbëjnë pjesë thelbësore të qëllimit të institucionit për të rritur zhvillimin e plotë të studentëve. Ato plotësojnë dhe shtojnë rezultatet e mësim nxënies në institucion dhe ofrojnë mundësi për studentët që të zgjerojnë horizontet e tyre në një mënyrë që nuk do të ishte e mundur vetëm brenda kufijve të kurrikulës së strukturuar.

Fushëveprimi/Përfshirja

I gjithë stafi akademik, ekspert të jashtëm, studentë dhe tutorë.

Parimet e politikës

Pjesëmarrja në aktivitetet bashkëkurrikulare dhe jashtëkurrikulare plotësisht është në përputhje me vlerat që mbështesin procesin edukativ dhe arsimor të Kolegjit Biznesi. Përmes kontributit të studentëve në aktivitetet bashkëkurrikulare dhe jashtëkurrikulare komuniteti i Kolegjit do të forcohet dhe kjo do të ndërtojë më tej ndjesinë e fortë shoqërore dhe motivimin në Kolegjin Biznesi. Gjithashtu, këto aktivitete ofrojnë mundësi për të nxitur marrëdhënie harmonike midis studentëve dhe stafit akademik, të cilat krijohen dhe zhvillohen përmes aktiviteteve që realizohen jashtë sallave të mësim. Nëse ka, preferencat dhe kualifikimet personale të studentëve do të merren parasysh. Dekani, duke pasur parasysh nevojat e Kolegjit Biznesi dhe në veçanti të studentëve të tij, rezervon të drejtën të caktojë aktivitete të veçanta bashkëkurrikulare dhe jashtëkurrikulare.

Qëllimet e aktiviteteve bashkëkurrikulare dhe jashtëkurrikulare

- Të nxisë besimin tek studentët dhe mësimdhënësit për të zhvilluar talentët dhe aftësitë e tyre.
- Të respektohet diversiteti i studentëve.
- Të inkurajohen studentët të jenë pozitivë në këndvështrimin e tyre për jetën dhe të japin një kontribut pozitiv në institucion dhe shoqëri.
- Studentët të përgatiten për arsimim të mëtejshëm dhe për botën e punës.



- Të zhvillohen vlerat e tolerancës, përfshirjes dhe kujdesit brenda institucionit dhe komunitetit më të gjerë.

Përfshirja e studentëve në aktivitete

Në shpalljen e publikuar për pranimin dhe regjistrimin e studentëve, në të cilin dokument janë të paraqitura plotësisht dhe qartë të gjitha kushtet e përcaktuara për regjistrimin në Kolegjin Biznesi. Gjithashtu kusht standard i regjistrimit është që çdo student të përfshihet plotësisht dhe në mënyrë aktive në aktivitetet bashkëkurrikulare dhe jashtëkurrikulare. Aktivitetet bashkëkurrikulare dhe jashtëkurrikulare pas orëve të zakonshme të mësimit janë pjesë e domosdoshme e procesit arsimor dhe edukativ të Kolegjit Biznesi. Studentët të cilët nuk kanë përzgjedhur fushat e tyre të preferuara të përfshirjes do të drejtohen në aktivitete të tjera bashkëkurrikulare dhe jashtëkurrikulare për të përmbushur angazhimet e tyre.

Përfshirja e stafit akademik në aktivitete

Stafit akademik i rregullt dhe i angazhuar të Kolegjit Biznesi në kontratën për punësim i është përcaktuar kushti se nga ata pritet të ndihmojnë dhe marrin pjesë aktive në aktivitetet bashkëkurrikulare dhe jashtëkurrikulare të Kolegjit Biznesi. Përfshirja e stafit akademik në aktivitetet bashkëkurrikulare dhe jashtëkurrikulare është pjesë e vlerësimit të stafit akademik. Stafit akademik do t'i ofrohen mundësi për të fituar kualifikime të përshtatshme për trajnim për aktivitetet bashkëkurrikulare dhe jashtëkurrikulare.

Transporti gjatë aktiviteteve

Nëse gjatë këtyre aktiviteteve paraqitet nevoja për transport, ai duhet të jetë i përshtatshëm dhe i mirëmbajtur dhe duhet të jetë në përputhje me rregullat përkatëse të sigurisë. Për mbështetjen e këtyre aktiviteteve Kolegji do të angazhohet që të siguroj transport për këto aktivitete.

Sjellja dhe Disiplina në aktivitete

Kodi i etikës i miratuar nga Kolegji Biznesi duhet të zbatohet nga stafi akademik dhe studentët në të gjitha aktivitetet bashkëkurrikulare dhe jashtëkurrikulare. Institucioni ka të drejtë të tërheqë një student ose grup studentësh nga një aktivitet për çdo shkelje të Kodit të etikës të institucionit.



Llojet e aktiviteteve

- **Sportive:** u mundësojnë studentëve të përjetojnë dhe forcojnë ndjenjën e tyre të miqësisë, konkurrencës, punës në grup, sportivitetit të mirë dhe krenarisë institucionale, ndërkohë që ofron shtigje për ata që kërkojnë nderime më të larta përfaqësuese. Gjithashtu studentëve u ofrojnë mundësi që të ushtrorjnë, të përmirësojnë aftësitë e tyre dhe të përfshihen në aktivitete më të shëndetshme.
- **Kulturore:** pjesë integrale e edukimit më të gjerë të studentëve dhe atyre të u ofrohen mundësitë për t'u angazhuar në fusha që janë me interes për ata. Gjithashtu ato përbëjnë një pjesë integrale të përvojës arsimore tërësore dhe ofrojnë shtigje për ata që kërkojnë përfaqësim në nivele më të larta. Studentët inkurajohen të performojnë më të mirën e aftësive të tyre dhe të u kujtohet gjithmonë se qëllimi kryesor është kënaqësia dhe zhvillimi i tyre.

Rolet dhe përgjegjësitë në aktivitete

- a) Menaxhmenti i institucionit/Përgjegjësit e Programeve studimore
 - Të vendosë strukturat dhe procedurat për zbatimin e politikës.
 - Të monitorojë zbatimin dhe të lehtësojë rishikimin e politikës.
 - Të mbështesë dhe afirmojë stafin akademik të përfshirë në aktivitetet bashkëkurrikulare dhe jashtëkurrikulare.
- b) Staf i akademik i rregullt dhe i angazhuar
 - Të zbatojë politikën dhe të japë sugjerime dhe komente për zbatimin e saj.
 - Të mbajë shënime për incidentet në aktivitetet bashkëkurrikulare dhe jashtëkurrikulare dhe t'i raportojë ato Dekanit/Prodekanit.
 - Të sigurojë ndërgjegjësimin e studentëve dhe pranimin e politikës.
- c) Studentët
 - Tu binden të gjitha udhëzimeve të mbikëqyrësve të aktiviteteve bashkëkurrikulare dhe jashtëkurrikulare dhe rregullave të Kolegjit Biznesi
 - Të njohin punën që po bëhet përmes aktivitetet bashkëkurrikulare dhe jashtëkurrikulare në emër të tyre duke qenë gjithmonë me respekt.
 - Të fitojnë kënaqësi dhe përmbushje nga përfshirja e tyre.



Rishikimi dhe Vlerësimi i Politikës

Programi i aktiviteteve bashkëkurrikulare dhe jashtëkurrikulare i nënshtrohet ciklit të rishikimit dhe vlerësimit vjetor. Ekipi i rishikimit do të përfshijë përfaqësues të Menaxhmentit të lartë të Kolegjit, Dekani, Prodekani, Përgjegjësit e Programeve studimore, stafit akademik dhe studentë. Ky rishikim do të mbledhë pikëpamjet dhe përvojat e të gjithë të përfshirëve në lidhje me suksesin e ofrimit të aktiviteteve

bashkëkurrikulare dhe jashtëkurrikulare brenda Kolegjit Biznesi. Gjatë këtij rishikimi edhe Politika për aktivitete bashkëkurrikulare dhe jashtëkurrikulare do të analizohet për të shqyrtuar ndikimin e politikës në aktivitetet bashkëkurrikulare dhe jashtëkurrikulare dhe për të adresuar çdo fushë të politikës që ka nevojë për ndryshim ose përmirësim.

Prishtinë, Shtator 2024



KLMSH/Dekan
Prof. Dr. Shyqeri Kabashi